# DËSHMI ARKIVI

**A-458912**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekspertët kërkojnë përgatitje të shtetit përballë plakjes së popullsisë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/arberi/ekspertet-kerkojne-pergatitje-te-shtetit-perballe-plakjes-se-popullsise` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 01:53:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 18:45:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9c06a6cb47eed714e84ea1618de497bb66850cfb6810a48728e1154effdb23e0` |
| TEKSTI | `149e86df24c1f1add3855f2703eb9e345386b733b0b7483b974bb0f8588087fc` |
| PAMJA | `aa52df02510f911229b2503c5e300b3a0115d0e1eabae8dc7b3d3424966831e4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3d82015bcf0b7e3d6deaff4ffbda8474a9beb25d4ebd19ca3b8de6319027a20c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1e2948ee29ab13edbd442d93c043487a99670263e579192fb4ff737734c16e45` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3d82015bcf0b7e3d6deaff4ffbda8474a9beb25d4ebd19ca3b8de6319027a20c`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

ARBËRI

# Ekspertët kërkojnë përgatitje të shtetit përballë plakjes së popullsisë



Foto: Ilustrim

19 shtator 2026 20:45

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

**Kosova po përballet me ndryshime demografike. Një në nëntë persona është mbi 65 vjeç, ndërsa numri i të moshuarve pritet të rritet edhe më tej në vitet e ardhshme. Ekspertët kanë thënë se kjo kërkon përgatitje të sistemit shëndetësor dhe social për t'iu përgjigjur nevojave të popullsisë që po plaket**

Një në nëntë persona në Kosovë është mbi 65 vjeç, kurse numri i të moshuarve është rritur ndjeshëm në pak më shumë se një dekadë, tregojnë statistikat zyrtare.

Ndryshimet demografike janë diskutuar edhe në konferencën "Plakja e shëndetshme – shkenca, kujdesi dhe inovacioni social", që u mbajt të shtunën në Prishtinë.

Ekspertët kanë kërkuar përgatitjen e sistemit shëndetësor dhe social për nevojat e një popullsie që po plaket.

"Sipas parashikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2025–2060, pritet që rreth 31 për qind e popullsisë, në një popullsi prej rreth një milion banorësh, të jenë mbi moshën 65-vjeçare. Kjo do të nënkuptonte rreth 350 mijë persona mbi 65 vjeç. Këto të dhëna tregojnë një mesazh të qartë: koha për të vepruar dhe për të avokuar është tani", ka thënë Agron Gashi, drejtor ekzekutiv i Institutit të Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale.

Gashi ka thënë se koncepti i pleqërisë së shëndetshme nuk duhet të kufizohet vetëm te zgjatja e jetëgjatësisë, por duhet të përfshijë funksionalitetin, pavarësinë dhe cilësinë e jetës.

Edhe



Arbëri • 2 kor 2026
Kosova po plaket, deri më 2060 mosha mesatare parashihet 49 vjeç

**Showbiz.**
"Animals" e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

**Futboll.**
Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Venezian

**Futboll.**
Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevillas

**Shtojca për Kulturë.**
Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

**Arbëri.**
Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

**Basketboll.**
Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

“Investimi duhet të bëhet shumë më herët, përmes parandalimit, aktivitetit fizik, mosstimulimit të duhanit dhe, nëse kemi ndonjë sëmundje, përmes kontrolleve dhe menaxhimit të duhur të saj”, është shprehur Gashi.

Plakja e popullsisë nuk është sfidë vetëm për Kosovën.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ky është trend global që kërkon riorganizimin e sistemeve shëndetësore dhe sociale.

Shefja e Zyrës së OBSH-së në Prishtinë, Isme Humolli, ka thënë se plakja e shëndetshme është një prej prioriteteve të organizatës dhe pjesë e planit të punës për vitet 2026-2030.

“Të dhënat e fundit tregojnë se numri i personave të moshës 60 vjeç e tutje është në rritje e sipër dhe ka një dinamizëm jashtëzakonisht të lartë. Në vitin 2019, numri i njerëzve të moshës 60 vjeç e lart ishte një miliard. Ky numër është duke u rritur dhe në vitin 2030 pritet të ketë 1.4 miliard persona të moshës 60 vjeç e mbi, ndërsa në vitin 2050 pritet të jenë 2.1 miliardë”, ka thënë Humolli.


Edhe



**Arbëri** • 2 jan 2026

Në vitin 2025 rreth 2 mijë raste të reja me kancer, rritje te moshat 30–50 vjeç


Në konferencë kanë ekspertë, studiues dhe profesionistë të fushave të shëndetësisë dhe politikave sociale. Ata kanë vënë theksin te qasjet shkencore, praktikat e kujdesit dhe inovacionet sociale, e që mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të moshuar.

*Egzona Mema*

#PLAKJA E POPULLLSISE   #AUTORITETET

## Artikuj të ngjashëm




**Arbëri** • 1 tet 2025

Pensionistët kërkojnë të kontribuojnë e të fitojnë



**Kuriozitet** • 10 o. më parë

Mbi 100 mijë njëqindvjeçarë në Japoni, shumica gra



**Kuriozitet** • 15 sht 2026

Për herë të parë, Japonia ka më shumë se 100.000 persona mbi 100 vjeç



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.